



# ANALIZA E ECURISË SË ÇMIMEVE TË DOMATES, KASTRAVECIT DHE SHALQINIT NË TREGJE TË SHUMICËS NË RAJON PERIUDHA 25 MAJ – 25 QERSHOR




Burimet: Çmimi Prishtinë: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Çmimi Rijeka: <http://www.tisup.mps.hr>



Çmimi FOB Prishtinë: Çmimi Mesatar – Transport/kg


Çmimi FOB Rijeka: Çmimi Mesatar – ((Transport+Zhdoganimi + Tarifa e Importit)/kg)




Burimi: Databaza e ACIT

Çmimi mesatar i domates në tregun e shumicës të Tiranës dhe Lushnjes për periudhën 25-Maj -25-Qershor 2009 vlerësohet respektivisht 65 lek/kg (0.49 €/kg) dhe 56 lek/kg (0.472 €/kg) shoqëruar nga luhatje të ndjeshme të çmimit. Ecuria e çmimit të domates së serës në tregjet e Tiranës, Lushnjes, Prishtinës dhe Rijekës janë paraqitur në grafikun I. Në të katërta, domatja është tregtuar gjatë gjithë periudhës së observuar. Çmimi i domates javën e katërt të Majit në Tiranë është luhatur rreth vlerës 68 lek/kg, për të vijuar me një ulje në 60 lek/kg në javën pasardhëse, shoqëruar nga një rritje e çmimit mesatar me 42% në 86 lek/kg javën e dytë të Qershorit dhe ulje në javët respektive në vlerat mesatare 54 lek/kg dhe 45 lek/kg. Luhatjet në çmim në tregun e Lushnjes, primar për domaten, janë ndjekur në njëpashmëri nga tregu i Tiranës, por çmimi në tregun e Lushnjes ka qendruar mesatarisht 14% më poshtë se ai i Tiranës. Tregu i Tiranës ka pasur dy periudha të shkurtra me mbi-ofertë të domates, në datat 29-30 Maj dhe 16-18 Qershor, gjatë të cilave çmimi i domates ka qenë më i ulët se në Lushnje. Çmimi në Prishtinë është luhatur rreth vlerës mesatare 100 lek/kg (0.76 €/kg) ose 80% më shtrenjtë se çmimi në tregun e Lushnjes. Rënia gjatë javës së parë është shoqëruar me qëndrueshmëri në javët pasardhëse. Tendenca e çmimit të domates në Rijeka ka qenë në rënie, por gjithsesi ai është rreth 3 herë më i lartë se mesatarja e periudhës në tregjet vendase duke u luhatur rreth vlerës 217 lek/kg (1.64€/kg). Grafiku 2 tregon çmimin maksimal FOB që mund të negociohet në tregjet jashtë vendit, përkatsisht në Rijeka dhe Prishtinë duke hequr nga çmimi i shumicës atje kostot e transportit, zhdoganimit dhe tarifat e importit (tarifa e importit në Kosovë është 0% kurse në Kroaci 15% për periudhën e observuar). Ashtu sikurse duket qartë nga grafiku 2 avantazhi konkurrues që mbart domatja vendase në çmim preket shumë pak nga tarifat dhe transporti. Hapësira negociuese mbetet më e madhe në Kroaci me gjithë kostot më të larta për kg (afërsisht 18 lek/kg) sesa në Kosovë (rreth 6 lek/kg). Kështu çmimi FOB Rijeka, Kroaci është mesatarisht 2.7 herë më i lartë se çmimi në tregun e shumicës të Lushnjes, kurse çmimi FOB në Prishtinë vetëm rreth 80% më i lartë. Diferencat në çmimet e shumicës midis tregjeve vendase dhe atyre të huaja, mungesa e domates së importit gjatë këtij sezoni, tendencat në rritje të eksporteve dhe në rënie të importeve (shih grafikun 3) vërtetojnë edhe njëherë avantazhet konkurruese që mbart ky produkt gjatë kësaj periudhe në nivel rajoni. Gjithsesi këto avantazhe kanë limitet e tyre kohore si duket qartë në grafikun 2 (domatja e vendit ka pësuar një rritje në çmim gjatë periudhës 10-15 Qershor, si pasojë e rritjes së kërkesës duke e sjellë atë pothuajse në nivelet e çmimit FOB Prishtinë). Kërkime të mëtejshme që fokusohen edhe në faktorë të tjerë si sjellja e preferencat konsumatore për produktin, konkurrenca etj., në këto tregje mund të nxjerrin më në pah shanset e vërteta të domates vendase në tregjet rajonale.






Burimet: Çmimi Prishtinë: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Çmimi Rijeka: <http://www.tisup.mps.hr>



Çmimi FOB Prishtinë: Çmimi Mesatar – Transport/kg

Çmimi FOB Rijeka: Çmimi Mesatar – ((Transport + Zhdoganim + Tarifa e Importit)/kg)



Burimi: Databaza e ACIT

Grafiku 7 tregon ecurinë e çmimit mesatar të shalqinit në 4 tregje shumice në tre vende të rajonit, Shqipëri, Kosovë dhe Kroaci. Shalqini në tregjet vendase ka qenë vazhdimisht prezent duke filluar nga data 29 Maj. Ai është luhatur rreth vlerës mesatare 36 lek/kg dhe 39 lek/kg respektivisht në tregun e Lushnjës dhe Tiranës. Tregu i Lushnjës dhe Tiranës kanë dëshmuar një diferencë minimale prej 3% në çmim gjatë periudhës së observuar, gjë që duket qartë në grafikonin 3, dhe kanë reaguar njësoj e në të njëjtën kohë me anë të luhatjeve të çmimit, duke dëshmuar ndërvarësi përsa i përket këtij produkti gjatë periudhës së observuar. Çmimi i shalqinit në tregjet vendase ka pësuar rënie deri më 10 Qershor. Deri në këtë datë çmimi ka zbritur nga vlerat fillestare prej 90 lek/kg në Lushnje e 68 lek/kg në Tiranë në 25 lek/kg. Kjo ulje është pasuar në vijim nga një qëndrueshmëri e çmimit rreth kësaj vlere. Çmimi i shalqinit në Kosovë ka pësuar gjithashtu ulje gjatë kësaj periudhe duke kapur vlerën 50 lek/kg në fund të periudhës dhe një ulje prej 212% në krahasim me çmimin fillestar (156 lek/kg). Ka shumë mundësi që kjo është ndikuar nga hyrja e shalqinit shqiptar, i cili sikurse vitet e mëparshme mbulon një pjesë të madhe të kërkesës për shalqi në Prishtinë. Megjithatë çmimi mesatar i shalqinit ka mbetur mesatarisht 171% me i lartë në Prishtinë gjatë gjithë periudhës. Krahasimi i tregjeve shqiptare të shumicës me tregun e shumicës të Rijeka-s vë në pah një diferencë edhe më të thellë të çmimit mesatar prej 260%. Shanset e këtij fruti për të përmbushur kërkesat e rajonit më tej duken shumë të mira për shkak të avantazheve konkurruese që ky shfaq me çmimin shumë të leverdisshëm që favorizohet edhe nga kushtet gjeografike e klimaterike e faktorë të tjerë që influencojnë çmimin si krahu i lirë i punës, niveli i jetesës, çmimet e inputeve, kostot e prodhimit etj. Kjo mbështetet edhe nga krahasimi i çmimit të tregut të Lushnjës me çmimin maksimal FOB me destinacion dy tregjet e rajonit në grafikonin 8. Kështu pavarësisht kostove të imponuara nga transporti e tarifat e importit (10% në Kroaci) diferenca në çmim midis Lushnjës dhe Rijeka-s shënon 228% kurse midis Lushnjës dhe Prishtinës 156% mesatarisht për periudhën. Edhe ecuria e flukseve tregtare të paraqitura në grafikonin 9, i cili pasqyron një balancë tregtare pozitive, gjë që ndodh me pak produkte shqiptare e mbështet këtë supozim. Nëse vëzhgojmë ecurinë e flukseve tregtare të të tre produkteve të observuara: domate, kastravec dhe shalqini, vëmë re se shalqini është produkti me peshën më domethënëse të eksporteve, ka arritur të mbulojë kërkesën vendase, ndërkohë që gëzon avantazh konkurrues në çmim. Domatja dhe kastravec janë larg këtij realiteti dhe nuk arrijnë të mbulojnë kërkesat e tregut gjatë stinës së ftohtë, megjithëse importet kanë ardhur duke u ulur. Gjithsesi pritet që pesha e domateve ndaj totalit të eksporteve të pësojë rritje duke influencuar pozitivisht në konkurrueshmërinë e këtij produkti në 2009-tën.